

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Prilijeno: 04.07.2022		
Njësia Jednic:	Numri Broj	Shtojca Dodatak
1-030/01-34859/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Raport nga mbledhja e parë publike e thirrur nga kryetari i komunës për vitin 2022

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.03/2020 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, e datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, Komuna e Lipjanit harton Raport nga mbledhja e parë publike e thirrur nga kryetari i komunës për vitin 2022 i cili është mbajtur me datën 27.06.2022, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 11:00. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin në gjashtëmujorit e parë të vitit fiskal dhe tjetrin në fundvit.


Ecuria e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit të standarteve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit ka bërë me kohë lajmërimin dhe ka publikuar njoftimin në ueb faqe të Komunës, në dy gjuhët zyrtare, dy javë para mbajtjes, sipas ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispoziata e Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit public në Komuna.

Po ashtu njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të komunës si dhe në vendet e tjera më të frekuentuara nga ana e qytetarëve.

Pas hartimit të këtij raporti dhe dhënies së protokollit të brendshëm, i njëjti do t'i dërgohet të gjitha drejtorive dhe njësive komunale.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1. Publikimi në ueb faqe	14 ditë pune	46
2.Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë pune	46



Në këtë tubim publik kanë marrë pjesë 46 pjesëmarrës, prej tyre 27 femra dhe 19 meshkuj.

Takimi i cili është mbajtur **27.06.2022** në ora **11:00** në sallën e Kuvendit Komunal ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e komunës njoftojnë për aktivitetet komunale, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe investimet kapitale gjatë periudhes për të cilën është thirrur takimi, ndërsa të pranishmit mund të bëjnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të

zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara si dhe për çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve.

Për të folur rreth aktiviteteteve të Komunës, për planet dhe sfidat, fjala kryesore i takoj kryetarit të komunës, Imri Ahmeti.

Në prani të kryesuesit Daut Azemi, drejtorëve të Drejtorateve komunale, përfaqësuesve të Këshillave Lokal përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe qytetarëve mbledhjen e hapi kryetari i Komunës, Imri Ahmeti.

Kryetari, Imri Ahmeti pasi ka përshëndetur të pranishmit ka thënë se në këtë takim jemi që të diskutojmë për punën e bërë përgjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2022, ai po ashtu ka shtuar se kemi arritur që në këtë periudhë që po e lëmë pas të realizojmë me sukses një sërë projektesh duke vazhduar të prezantoj punën e tij, ai ka theksuar se kjo periudhë por edhe në atë të cilën gjendemi është një ndër më të vështirat që po kalojmë si vend, ku inflacioni dhe krizat e vazhdueshme ekonomike e socio-ekonomike që po godasin Republikën e Kosovës dhe jo vetëm, kanë reflektuar e po vazhdojnë të reflektojnë edhe në punën tonë si ekzekutiv komunal.

Pavarësisht kësaj mund të them me përgjegjësi të plotë se ne kemi arritur që gjatë kësaj periudhe gjysmë vitin 2022 ta përmbyllim me sukses ashtu edhe qysh e kishim planifikuar në planin tonë të punës dhe për këtë falenderoj qytetarët për angazhimin e tyre për të fuqizuar dhe ndihmuar ekzekutivin në rritjen e performances dhe uljen e defekteve në menaxhimin e financave publike.

Më tutje kryetari Imri Ahmeti ka shpalosur edhe disa nga të arriturat e ekzekutivit përgjatë këtij gjashtëmujori, duke theksuar se në vazhdimësi jemi angazhuar që të gjithë qytetarëve lipjanas t'iu ofrojmë kushte dhe shërbime sa më cilësore. Jam i kënaqur me rezultatin e arritur nga Komuna e Lipjanit, ku performanca e mirë në zbatim të ligjit dhe transparencës e llogaridhënies, ka bërë që Lipjani të renditet si komuna e dytë në nivel vendi dhe nga kjo renditje kemi fituar grant në vlerë prej mbi 1 milion euro (1,021,108.38).

Kryetari Imri Ahmeti në takimin e parë me qytetarët ka njoftuar ata, se Komuna e Lipjanit po ashtu është përfituese edhe e 422,351.00 eurove, donacionit nga GIZ – Gjerman, për skemën “Gara për Mjedis të Pastër”, si dhe përfituese e dy kamionëve për grumbullimin e mbeturinave. Për ne nuk janë të rëndësishme vetëm projektet në vlerë monetare, por edhe projektet që krijojnë standard të qëndrueshme dhe që ndihmojnë komunën në ndërtimin e kapaciteteve tona humane për një periudhë afatgjatë. Ndihej mirë që jemi në mesin e tetë komunave të përzgjedhura nga USAID, për implementimin e projektit “Integriteti i Komunave të Kosovës”, projekt ky që do të implementohet në periudhën e ardhshme 5 vjeçare (2022 - 2027).

Po ashtu qytetarët njoftuan për të hyrat buxhetore të cilat janë duke u realizuar ashtu siç janë planifikuar dhe një trend i tillë tregon që edhe këtë vit do të tejkalojmë të hyrat vetanake dhe ka treguar se tatimi në pronë është njëra ndër kategoritë që ofron stabilitet buxhetor dhe në fund të vitit presim të realizohet %.

I pari i komunës, në takim e sotëm me qytetarë ka theksuar se gjatë kësaj periudhe për të cilën po flasim një rëndësi e vaçant i kemi kushtuar funksionalizimit të Zonës Ekonomike në Qylagë, një zonë mjaft e rëndësishme për zhvillimin ekonomik jo vetëm për komunën e Lipjanit po edhe më gjerë. Vlenë të theksohet se është proceduar dhe aprovuar në Kuvendin Komunal propozimi vendimi për fillimin e procedurave për shpalljen e konkursit publik për vendosje të bizneseve në këtë zonë dhe presim që shumë shpejt të kemi biznese që do të fillojnë aktivitetin e tyre aty.

Po ashtu, qytetarët u njoftuan edhe për mbështetjen institucionale ku në pjesën e parë të vitit 2022 është vazhduar me subvencionimin e Klubeve Sportive dhe këto klube do të gjejnë përkrahje të vazhdueshme në Komunën e Lipjanit. Janë subvencionuar gjithësej 19 Klube Sportive në vlerë prej mbi 100 mijë euro. Gjithashtu gjatë këtij gjashtë mujori është financuar edhe në botime të librave si dhe aktivitete të ndryshme kulturore dhe rinore.

Kryetari Imri Ahmetika njoftuar qytetarët lidhur me projektet dhe ecurinë e tyre në fushën në fushën e Arsimit, rritjen e numrit përfitues së bursave për student, si dhe për nismat e ndërmarra në renovimin e disa shkollave të komunës, por ka informuar qytetarët edhe për projektet infrastrukturore, ku theksoi se për shkak të ngritjes së çmimeve punimet kanë stagnuar në disa projekte që kanë qenë në vazhdim nga vitet paraprake. Mirëpo ne po mbikqyrim dinamiken dhe ecurinë e punimeve në projektet siç janë: Objekti i Administratës së Komunës, objekti i palestrës sportive në Lipjan, rruga “Marie Shllaku” deri në fshatin Rufc, rruga Lipjan-Rubovc, rrugët në lagjen e Akllapit, Asfaltimi i rrugicave në Rubovc, Janjevë, Akllap, Rufc, Banullë, Zllakuqan, Krojmir dhe Vërshevc faza II etj.

Por kryetari Ahmeti ka potencuar se një varg i punëve janë kryer dhe ne po presim të kryhen edhe disa projekte tjera në bashkëfinancim me donator, ndërsa projekte të tjera të planifikuara në kuadër të investimeve kapitale për vitin 2022, janë kontraktuar dhe pritet fillimi i punëve në ditët në vazhdim.

Takimi ka përfundur në ora 12:30

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetje / komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2022	Qfarë veprime kka nëmarrë komuna me lidhur me rritjen e çmimeve	Bekim Krasniqi nga OJQ - YAHR	Ne tani së fundi kemi hartuar Kornizen Afatmesmme buxhetore për vitet 2023-2025 dhe kemi paraparë të rrisim subvencionet në disa drjetori por presim edhe reflektim dhe diihmë nga niveli qendror për lidhur me ngritjen e çmimeve.	Pjesërisht: Komuna së fundi ka hartuar Kornizen Afatmesmme buxhetore për vitet 2023-2025 dhe kemi paraparë të rrisim subvencionet në disa drjetori por presim edhe reflektim dhe diihmë nga niveli qendror për lidhur me ngritjen e çmimeve.
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2022	Kur do të filloi, ndërtimi i shtëpisë së Kulturës në Lipjan	Ferdian Shala nga shoqëria Civile	Gjatë hartimit të KAB cili shumë shpejtë do të aprovohet në kuvend kemi planifikuar buxhet që për dy vitet ardhshme të ndërtohet Shtëpia e Kulturës në Lipjan.	Plotësisht: Me KAB është planifikuar buxhet që për dy vitet ardhshme të ndërtohet Shtëpia e Kulturës në Lipjan.
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2022	Është një kërkesë e grupit të Grave në Lipjan që në objektin e ri të Administratës komunale të	Hyra Bytyçi Kryesuese e Grupit të Grave në Lipjan	Adresimi i kërkesave në drejtim të komunës merret shumë seriozisht mbështesë në iniciativat e juaja	Plotësisht: Mbështeten iniciativat e grupit të grave aty ku konsiderohet që


	vendooset dhe të promovohet "Këndi i Kurajos", cili a për qëllim të përqon zërin e krimeve të luftës në veqanti ndaj grave.		aty ku konsideroni që fuqozohen dhe mbështen gratë në përgjithësi. Filloni me procedurat patjetër që do të kenë mbështetjen institucionale.	është e nevojshme në rolin e tyre drejtë fuqizimit.
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2022	Kur do të bëhet hapja e qerdheve në Sllovi dhe Gadime.	Aurela Hoxha-Qytetarë	Kryetari Imri Ahmeti: Janë në përfundim punimet në qerdhet e fshtrave Sllovi dhe Gdime dhe së shpejti do të procedojmë kokursin për pranim të stafit dhe fëmijëve. Besojmë në shtator të fillojmë.	Plotësisht: Në shtator do të fillohet puna me fëmijënë këto dy institucione
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2022	A do të ndaj Komuna bursa për student edhe në vitin 2022	Vesa Rrahani – shoqëri civile	Komuna ka planikuar me buxhet për bursa për student por është duke u shikuar mundësia për rritjen e numrit të bursave.	Plotësisht: Janë planifikuar me buxhet bursat për student po ashtu është rritur edhe nuri i përfituesve
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2022	A do të ketë konkurs në Arsim për pozitata e lira dhe a do të bëhet përzgjedhja në bazë të meritokracisë	Erblina Salihu OJQ YAHR	Konkursi për mësimdhënës do të jetë i hapur dhe ju inkurajoj të aplikoni, nëse hasni në parregullsi ju lutem raportoni ato tek organet përgjegjëse	Plotësisht: Konkursi për mësimdhënës do të jetë i hapur për të gjithë ata të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret e parapara.
Tubimi i parë	Me sheshin e	Dion Jashari	Komuna ka	Plotësisht:

publik i kryetarit për vitin 2022	qytetit i cili është thënë se do të vazhdoj me ndërtimin edhe në pjesën tjetër të qytetit a do filloi të implementohet ky projekt	qytetarë	planifikuar në buxhetin e saj për vitin 2023 dhe 2024 të vazhdoj me ndërtimin e sheshit edhe në pjesën tjetër të qytetit.	Është planifikuar me buxhet për dy vitet e ardhshme i vazhdimi të ndërtimit të sheshit
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2022	A do ndërtohet objektit i ri për persona me nevoja te veqanta në Lipjan	Valdrin Bytyqi qytetarë	Po Komuna e Lipjanit tani ka filluar me përgaditjen e procedurave për ndërtimin objektit i ri për persona me nevoja te veqanta në Lipjan ku dhe janë paraparë mjetet buxhetore për këtë projekt.	Plotësisht: Ndërtimi i objektit të ri për persona me nevoja te veqanta në Lipjan d të filloj vitin e ardhshëm
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2022	Ambientet e sallës së sporteve Beter Life në Lipjan duhet të renovohen sepse kanë nevojë dhe a ka ndonjë plan komuna lidhur me këtë	Art Krasniqi qytetarë	Kërkesë me vend dhe kërkoj nga Ekzekutivi të trajtoj këtë çështje	Pjesërisht: Komuna do të kujdeset që të merret me këtë çështje
Tubimi i parë publik i kryetarit për vitin 2022	A do do të ndërtohen edhe parqe tjera dhe kënde të lodrave për fëmijë në qytet por edhe në fshatra	Behare Gashi Qytetare	Ndërtimi i parqeve dhe këndeve të lodrave për fëmijë janë kërkesa të vazhdueshme nga qytetarët dhe ne jemi duke ndërtuar ato në disa fshatra por edhe kemi parapa që edhe	Plotësisht: Komuna edhe në pjesën e parë të këtij vitit që jemi po vazhdon me ndërtimin e parqeve dhe këndeve të lodrave për fëmijës si dhe ka ndarë mjete buxhetore që të ndërtoj edhe në

			në vitin e ardhshëm dhe vitet e tjera në vazhdim të ndërtojmë hapësira të tilla.	vitet e ardhshme hapësira të tilla.
--	--	--	---	--

Shtojcë : Lista e pjesëmarrësve

Udhëheqëse e Sektorit për Komunikim me Publikun













Bukurie Zejnullahu Jashari

Lipjan, 04.07.2022

REGJISTRI I PREZENCËS SË QYTETARËVE TË KOMUNËS SË LIPJANIT, NË
DËGJMIN PUBLIK TË MBAJTUR ME 27.06.2022, NË SALLËN E
KUVENDIT ME FILLIM NË ORA 11:00

Nr. Ren	Emri dhe Mbiemri	Venbanimi	Nënshkrimi
1	Andresa Terjanica	Piperi Vigli	Andresha
2	Butirje Zymullahu	Benullë	Butirje
3	Dion Jashari	Benullë	D. Jashari
4	Safete Amerllahu	Shalë	Sm. Amerllahu
5	Behar Amerllahu	Shalë	Behar
6	Visar Bikiçi	Jahjeve	Visar
7	Behare Gashi	Sllovi	Bm. Gashi
8	Rrahime Gashi	Sllovi	Rr. Gashi
9	Verine Gashi	Lipjan	V. Gashi
10	Veldi Bytyci	Dylugë	V. Bytyci
11	Leonida Asllani	Lipjan	Leonida
12	Enver Isufi	Gashë	Enver
13	Danila Ahmeti	Toran	Danila
14	Besarta Boshko	Jonjari	Besarta
15	Volter Agushi	Lugut	V. Agushi
16	Shehadje Ibrahim	Lipjan	Shehadje
17	Islam Kaleshi	Qellore	Islam
18	ALBULENA KALESHTI	Qellore	Albulena
19	VLOKA KRAMIRI	LIPJAN	Vloka
20	Lemrije Gjuroi	Lipjan	Lemrije
21	Burim Rrustemi	Dobrojtë e Modhe	Burim
22	Noim Stullca	Lipjan	N. Stullca
23	Melide Shkëmbi	Medvec	Melide
24	Gentijan Bytyci	Dylugë	Gentijan
25	Besarta Qadri	Blimë	Besarta
26	Bleta Aliu	Medvec	Bleta
27	Trimza Pucelli	Dylugë	Trimza
28	Jindri Shkëmbi	Medvec	Jindri
29	Milaim Meja	MAGUR	Milaim
30	Xherde Meja	MAGUR	Xherde

KUVENDIT ME FILLIM NË ORA 11,⁰⁰

Nr. Ren.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1	BEKIM KRASNIQI	YAHK	
2	Jerdian Shala	YAHK	
3	Art Krasniqi	YAHK	
4	Adrit Dakuhi	YAHK	
5	Lizabeta Krasniqi	Lipjan	
6	Antigona Hyseni	RUGC i Ri	
7	Behar Syljmani	RABUSK	
8	Bertim Shala	Vrehe	
9	HYRA BYTYCT	QYLAGJE	
10	Blerita Shala	Shali	
11	Merita Bexheti	Lipjan	
12	Adil Vllameti	Lipjan	
13	XHYE Krasniqi	SHITA	
14	Leonora Haxhiu	RUBOFC	
15	AURBIA HoxHAJ	LIPJAN	
16	Gafur Hetu	Komun	